

**ALBPETROL SHA PATOS**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data 13.09.2021

Nga: "Albpetrol" sha - Patos

Drejtuar: "ALBTELECOM" sha,

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi Square 21, Tirane,

NUIS J61824053N

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-02304-08-04-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Shërbim i internetit".

Kohezgjatja e kontrates është 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike: 09 Gusht 2021 nr.119

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "ALBTELECOM" sha me NUIS J61824053N, me vlerë oferte në total 1 800 000 lekë (pa TVSH).
2. Operatori ekonomik "VODAFONE ALBANIA" sha me NUIS K11715005L, me vlerë oferte në total 1 683 600 lekë (pa TVSH).
3. Operatori ekonomik "Tele.co.Albania" shpk me NUIS J72510459J, nuk ka paraqitur oferte ekonomike per kete tender.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik "VODAFONE ALBANIA" sha me NUIS K11715005L për arsyet e mëposhtëme:
  - Ne DST, kriteret e vecanta te kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.7 eshte kerkuar : "Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 3 (tre) inxhinierë te certifikuar me SCTE ose ekuivalente". Operatori Vodafone Albania ka deklaruar ne "Deklaraten per disponimin e punonjesve", pjese e formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojces nr. 9 te DST, se ka ne stafin e tij 3 inxhinierë te certifikuar me SCTE. Nga verifikimi i dokumentacionit te derguar nga operatori, pas kerkeses per sqarim te paraqitur nga komisioni i vleresimit te ofertave, vihet re se nga ana e operatorit nuk eshte plotesuar gjithë dokumentacioni mbeshtetes qe verteton vetedeklarimin per disponimin e 3 punonjesve

inxhinierë të certifikuar me SCTE. Rezulton se vetëm 1 (një) prej punonjësve të certifikuar me SCTE disponon diplomën e arsimit të lartë (elektronik/telekomunikacion/informatik/TIK). Ndërsa punonjësit e tjerë që kanë këtë certifikim, nuk kanë diplomën e arsimit të lartë, kjo në kundërshtim me pikën 2.3.7, kapaciteti teknik në DST.

- Operatori ekonomik “Tele.co.Albania” shpik me NUIS J72510459J për arsye të mëposhtme:
  - Nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe asnjë dokument që të provojë kërkesat ligjore ekonomike dhe teknike siç kërkohej në DST

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “ALBTELECOM” sh.a me NUIS J61824053N me adresë Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi Square 21, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1 800 000 (një milion e tetëind mijë) leke pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Florjan MUCAJ**